

VENDIM
Nr.617, datë 8.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE
MËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Lidhja nr.1 “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë”, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 2/I ndryshohet si më poshtë vijon:

“2/I. Paga e grupit, sipas nivelit arsimor të kërkuar nga vendi i punës, është si vijon:

Grupi 1- 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë. Në këtë grup përfshihen:

- Diplomë e Nivelit të Dytë (DND);
- Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND);
- Të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

Grupi 2-10 000 (dhjetë mijë) lekë. Në këtë grup përfshihen:

- Diplomë e Nivelit të Parë (DNP);
- Të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

-Diplomë e shkollës së mesme pedagogjike, për të cilat jepet titulli “Mësues i shkollës fillore”;

- Diplomë e shkollës së mesme profesionale, për të cilat fitohet specialiteti për mësuesi;

- Diplomë mbi shkollën e mesme. Të tilla konsiderohen të gjitha diplomat e kurseve me program mësimor të miratuar nga MASH-i, si dhe të gjithë ata që kanë mbaruar dy vite akademike të shkollës së lartë.

Grupi 3 - 8 000 (tetë mijë) lekë. Në këtë grup përfshihen diplomat e shkollës së mesme.”

2. Efektet financiare për vitin 2010, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2010.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA E PAGËS PËR PUNONJËSIT MËSIMORË TË ARSIMIT

PARAUNIVERSITAR

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	
		1	2	3	4
1	Drejtor i shkollës së mesme Drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë Drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë Drejtor në shkollat me probleme të larta mendore Drejtor i konvikteve	1	2% e PG	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G..	49 000
2	Zëvendësdrejtor i shkollës së mesme Përgjegjës i bazës prodhuese Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë Zëvendësdrejtor në shkollat me probleme të larta mendore	1	2% e PG	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G..	44 000
3	Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve	1	2% e PG	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G..	42 000
4	Drejtor i shkollës 9-vjeçare	1	2% e PG	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G..	40 000
5	Drejtor i shkollës fillore klasa I-IV Përgjegjës (kryemësues) i shkollës me klasë kolektive Zëvendësdrejtor i shkollës 9-vjeçare.	1	2% e PG	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G..	37 500
6	Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	2% e PG	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G..	36 000
7	Drejtor i kopshtit me ushqim	1	2% e PG	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G..	36 000
8	Drejtor i kopshtit pa ushqim	1	2% e PG	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G..	33 000
9	Mësues në shkollat e mesme Mësues në institutin e nxënësve që nuk shikojnë Mësues në institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë Mësues në shkollat me probleme të larta mendore	1	2% e PG	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G..	35 000
10	Inspektor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	2% e PG	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G..	34 000
11	Mësues në shkollat 9-vjeçare, klasa I-IX Edukator konvikti Kujdestar konvikti	1	2% e PG	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G..	32 000
12	Edukator në kopësht fëmijësh	1	2% e PG	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G..	29 000
13	Mësues	2 ose 3	2% e PG	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G..	26 000
14	Edukator në kopësht fëmijësh	2 ose 3	2% e PG	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G..	24 500